

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

VARIANTI **A**

E premte, 9 shtator 2011

Ora 10.00

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

### Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

### Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9a	9b	10a	10b	10c
Pikët														
Kërkesa	11	12a	12b	12c	13	14	15	16	17	18	19a	19b	20a	20b
Pikët														
Kërkesa	20c	21a	21b	22a	22b	23a	23b	23c	24a	24b	25a	25b	25c	25d
Pikët														

Totali i pikëve

### KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Martesa e Halilit****(fragment)**

**I-** T'tanë për darkë Muji i ka ndalë.  
 Kqyr shka bani Gjeto Basho Muji  
 u ka vu një barrë dru t'vogël n'zjarrm,  
 tre qind vetë pr i herë m'u xe.  
 At'herë trimi u ka avitë bucelat,  
 at'herë trimi u ka avitë fucijat;  
 i'n bucelat plot raki,  
 i'n fuçijat plot venë.  
 Sa shpejt frima burrave u ka ardhë,  
 sa shpejt gjaku trimave po u xehet!  
 Kanë marrë llafin e po llafiten,  
 kanë marrë gazin e po gazmojnë,  
 Kanë nisë trimat Mujin p'e pvetin;  
 "N'votër tande kem' qillue,  
 mos na ki randë për një fjalë:  
 pash një Zot, Muj qi t'ka dhanë,  
 qysh Halilin s'e martove?,"

.....

**II-** "S'e kam lanë për pare pse nuk pata,  
 s'e kam lanë, për vashë pse n'u mund hasa,  
 s'kam dashtë vetë m'u martue!"  
 "Pa ndigjo, more djalë ti djalë,-  
 ka folë plaku Osman Aga.-  
 Ditë e madhe nesër ka qillue,  
 tridhjetë agë kanë me u bashku,  
 tridhjetë vashat t'i kanë pru:  
 njat ma t'mirën ke me e zgjedhë.  
 Tridhjetë agë për hajr ta bajmë".  
 S'pe len djali plakun ma me folë:  
 "Zoti u vraftë, more agt' e Jutbinës!  
 Nji be t'madhe qi kam ba,  
 qi, ja martohem me gur e dhe,  
 ja e kam marrë Tanushën e Krajlit!,"

Për pyetjet nga 1-7 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

1. Cikli i Kreshnikëve përbëhet nga rapsodi ku u këndohet bëmave: **1 pikë**
- A) të dy personazheve kalorsiakë  
 B) të heronjve romakë  
 C) të heronjve grekë  
 D) të dy vëllezërve dhe 30 shokëve të tyre
2. Si paraqiten ngjarjet në këngët e Ciklit të Kreshnikëve? **1 pikë**
- A) të thjeshta  
 B) të ndërlikuara  
 C) të hiperbolizuara  
 D) të zvogëluara
3. Cikli i Kreshnikëve merr formën e këngëve legjendare nga: **1 pikë**
- A) prania e elementit të kuvendimit  
 B) përfshirja e qënieve përrallore  
 C) prania e natyrës së qetë  
 D) kontradiktat midis grupeve shoqërore
4. Figura e Mujit në këtë fragment karakterizohet më shumë nga fakti që ai: **1 pikë**
- A) shfaq mençuri dhe vlera etike si i pari i familjes  
 B) gëzon të drejtën për të folur si vëlla i Halilit  
 C) nuk mundet të shprehet bindshëm mbi problemin që diskutohet  
 D) e merr fjalën në kuvend në momentin më të keq
5. Figura tingullore e përdorur në vargjet:  
*At'herë trimi u ka avitë bucelat,*  
*At'herë trimi u ka avitë fucijat,* është: **1 pikë**
- A) asonanca  
 B) aliteracioni  
 C) onomatopeja  
 D) anafora
6. Cili nga elementët e mëposhtëm i jep muzikalitet fragmentit? **1 pikë**
- A) krahasimi  
 B) epiteti  
 C) përsëritja  
 D) hiperbola
7. Folja në vargun: *Zoti u vraftë, more agt' e Jutbinës!*, është në mënyrën: **1 pikë**
- A) dëshirore  
 B) dëftore  
 C) kushtore  
 D) lidhore

8.

a) Cila është ngjarja kryesore në këtë fragment?

1 pikë

---

b) E papritura është pjesë e krijimtarisë popullore.  
A kemi këtu ndonjë të papritur? Ç'efekt krijon ajo?

2 pikë

---

---

9.

a) Gjeneri në fragment një rimë foljore dhe një rimë emërore.

2 pikë

rimë emërore: \_\_\_\_\_

rimë foljore: \_\_\_\_\_

b) Përse shërbejnë këto rima?

1 pikë

---

10. Identifikoni në fragment momentin kur flitet për traditën e gostitjes si edhe përdorimin e numrit tridhjetë. Shpjegoni rolin e tyre në mesazhin që përcjellin në këto vargje.

a) vargjet ku flitet për traditën:

1 pikë

---

b) vargjet ku përdoret numri tridhjetë:

1 pikë

---

c) roli i përdorimit të tyre:

1 pikë

---

---

11. Si jepet në vargjet e mëposhtme diferenca midis *njeriut burrë* dhe *njeriut trim*?

\*Sa shpejt frima burrave u ka ardhë,

Sa shpejt gjaku trimave po u xehet?

2 pikë

---

---

12. Ndaluni në vargun: *T'tanë për darkë Muji i ka ndalë.*Ç'tregon fakti që Muji i ka ftuar të gjithë për darkë ose *t'tanë*? Pse këtë rol e luan Muji?

Në cilën klasë të fjalëve bën pjesë "t'tanë"?

a) \_\_\_\_\_ 1 pikë

b) \_\_\_\_\_ 1 pikë

c) \_\_\_\_\_ 1 pikë